



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.127

20 shtator

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 308 datë 22.7.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar	6805
Vendim i Kuvendit nr.57, datë 16.9.2010	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim ministri	6808
Vendim i Kuvendit nr.58, datë 16.9.2010	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim ministri	6808
Vendim i Kuvendit nr.59, datë 16.9.2010	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim ministri	6809
Vendim i Kuvendit nr.60, datë 16.9.2010	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim ministri	6809
Vendim i KM nr.678, datë 13.8.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Infermierisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për kuotën e pranimit dhe tarifën e shkollimit në këto programe studimi	6810
Vendim i KM nr.679, datë 13.8.2010	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Akademia Botërore e Tiranës” (World Academy of Tirana)	6811
Vendim i KM nr.680, datë 13.8.2010	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë e mesme “Gjimnazi Kristian i Tiranës” Gjerasim D.Qirjazi”	6811
Vendim i KM nr.686, datë 2.6.2010	Për krijimin e Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil	6812

Vendim i KM nr.688, datë 18.8.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”	6813
Vendim i KM nr.689, datë 13.8.2010	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes financiare, ndërmjet KfW, Frankfurt am Main dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (përfituesi), për shumën 975 475 euro, për shërbimet e ekspertizës së marrësit, në kuadër të studimit të fizibilitetit për programin “Infrastruktura vendore II”, financuar nga fondi i veçantë (Studien-Und Beratungsfonds) 6021, dhënë nga Qeveria Gjermane	6816
Vendim i KM nr.690, datë 13.8.2010	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes financiare, ndërmjet KfW, Frankfurt am Main dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (përfituesi), për shumën 949 750 euro, për shërbimet e ekspertizës së marrësit, në kuadër të studimit të fizibilitetit për programin “Infrastruktura vendore I”, financuar nga fondi i veçantë (Studien-Und Beratungsfonds) 6021, dhënë nga Qeveria Gjermane	6820
Vendim i KM nr.691, datë 13.8.2010	Për një përjashtim nga vendimi nr.53, datë 21.1.2009 i Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar	6825
Vendim i KM nr.692, datë 13.8.2010	Për lejimin e Ministrisë së Brendshme, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit për disa mallra dhe shërbime	6825
Vendim i KM nr.693, datë 18.8.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar	6826
Vendim i KM nr.694, datë 18.8.2010	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.748, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”	6830
Vendim i KM nr.695, datë 18.8.2010	Për dhënie fondi këshillit të qarkut të Lezhës, për rindërtimin e këmbëve të urës së Gallatës dhe montimin e urës tip “Beili”	6831
Vendim i KM nr.696, datë 18.8.2010	Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me institucionet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë	6832
Vendim i KM nr.697, datë 18.8.2010	Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia ...	6832

Vendim i KM nr.699, datë 13.8.2010	Për kalimin në përdorim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Ismail Qemali”, të objektit “Departamenti i detarisë”, në Vlorë	6833
Vendim i KM nr.701, datë 25.8.2010	Për një shtesë në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar	6833
Vendim i KM nr.702, datë 25.8.2010	Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shtetit të Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik	6836
Vendim i KM nr.704, datë 25.8.2010	Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me institucionet në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	6838
Vendim i KM nr.705, datë 25.8.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncension të hidrocentralit “Meshteken” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë	6840

LIGJ
Nr.10 308, datë 22.7.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004
“PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 13, në fund të pikës 1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:
“Procesit të vlerësimit të pronës, si më sipër, i nënshtrohen, domosdoshmërisht, prona në formën e truallit, truallit industrial apo të çdo lloj sipërfaqeje tjetër toke.”.

Neni 2

Në nenin 15, paragrafi i parë i shkronjës “b” ndryshohet si më poshtë:
“b) përfundon shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, si edhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të depozituara në AKKP nga subjektet e përcaktuara në ligj, brenda afatit për ushtrimin e së drejtës së ankimit. Në rast se kërkesa paraqitet jashtë afatit për ushtrimin e së drejtës së ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos mospranimin e kërkesës dhe njofton me shkrim kërkuesin për arsyen e refuzimit.”.

Neni 3

Pas nenit 16 shtohen nenet 16/1, 16/2, 16/3, 16/4, 16/5, 16/6 dhe 16/7 me këtë përmbajtje:

“Neni 16/1

Rishikimi i vendimeve

AKKP-ja, mbi bazën e një kërkesë për rishikim, shqyrton vendimet e ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qark, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, kur:

a) zbulohen rrethana të reja apo akte të reja shkresore që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen gjatë shqyrtimit të kërkesës për njohje, kthim apo kompensim të pronës;

b) vërtetohet se aktet shkresore, në bazë të të cilave është dhënë vendimi, të kenë qenë apo të jenë deklaruar më pas të pavërteta me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) vërtetohet se aktet shkresore, në bazë të të cilit është dhënë vendimi, të jenë lëshuar nga zyrtarë të dënuar penalisht për lëshimin e tyre;

ç) vendimi përmban një gabim material në fakt ose në ligj, bazuar në faktet e administruara në dosje gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës për njohje, kthim apo kompensim të pronës;

d) zyrtarët që kanë marrë pjesë në dhënien e vendimit kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit;

dh) vendimi është bazuar në një vendim gjyqësor ose akt të një organi tjetër, që ka ndikuar në marrjen e vendimit, dhe që më pas është prishur/ndryshuar.

Neni 16/2

Vendimet që mund të rishikohen

Kërkesa për rishikim mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qark, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, të cilat nuk janë duke u shqyrtuar në themel në gjykatë, apo për të cilat gjykata nuk ka dhënë një vendim themeli të formës së prerë.

Neni 16/3

Subjektet që mund të kërkojnë rishikim

Kërkesa për rishikim mund të paraqitet nga:

- a) çdo subjekt i shpronësuar, sipas përcaktimit të nenit 2 të këtij ligji, e drejta e njohjes, kthimit apo kompensimit të pronësisë i është cenuar nga vendimi që kërkohet të rishikohet;
- b) personat juridikë publikë, nëse vendimi që kërkohet të rishikohet ka cenuar të drejtat pasurore shtetërore, të cilat, sipas ligjit të kohës, nuk i nënshtroheshin procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës;
- c) Avokatura e Shtetit, bazuar në nenin 5 pika 1 shkronja “e” të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”.

Neni 16/4

Afati i paraqitjes së kërkesës

Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 45 ditëve nga dita që kërkuesi ka marrë dijeni efektivisht për shkakun e rishikimit. Nëse vendimi kërkohet të rishikohet nga Avokatura e Shtetit, kërkesa duhet të paraqitet në çdo rast jo më vonë se pesë vjet nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit në rast se vendimi kërkohet të rishikohet. Avokatura e Shtetit mund të marrë dijeni për shkakun e rishikimit kryesisht nga ushtrimi i funksioneve të veta ose me njoftim nga institucionet shtetërore dhe entet publike.

Neni 16/5

Kërkesa për rishikim

1. Kërkesa paraqitet me shkrim dhe tregon vendimin që kërkohet të rishikohet, legjitimitimin e subjektit kërkues, shkakun për të cilin kërkohet rishikimi, aktet shkresore që mbështesin shkakun e rishikimit, datën e lindjes së shkakut të rishikimit dhe datën e marrjes dijeni efektivisht mbi shkakun e rishikimit të kërkuesit.
2. Kërkesës për rishikim i bashkëngjiten:
 - a) kopje e vendimit që kërkohet të rishikohet;
 - b) kopje të akteve shkresore që vërtetojnë shkakun e rishikimit;
 - c) kopje të akteve shkresore që vërtetojnë datën e marrjes dijeni efektivisht.
3. Kërkesa e paplotësuar me elementet e mësipërme kthehet për plotësim nga AKKP-ja. Në rast se kërkesa nuk plotësohet brenda një afati 15-ditor, AKKP-ja vendos mospranimin e kërkesës, për shkak të mungesës së elementeve të domosdoshme të parashikuara nga ligji.

Neni 16/6

Procedura e verifikimit paraprak

1. Brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës ose nga plotësimi i mangësive të kërkesës, AKKP-ja analizon:

- a) legjitimitimin e kërkesës;
- b) afatin e paraqitjes së kërkesës për rishikim;
- c) nëse vendimi mund të rishikohet sipas nenit 16/2 të këtij ligji; dhe
- ç) nëse shkak i pretenduar për rishikim parashikohet në ligj.

Nëse edhe një prej këtyre kushteve nuk përmbushet, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos mospranimin e kërkesës për rishikim. Kundër vendimit për mospranimin e kërkesës për rishikim mund të bëhet ankim, sipas rregullave për ankimin ndaj akteve administrative.

2. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos sipas pikës 1 të këtij neni edhe kur kërkesa për rishikim është haptazi e pabazuar ose përsëritje e një kërkesë të rrëzuar, të mbështetur mbi të njëjtin shkak.

Neni 16/7

Shqyrtimi në themel dhe vendimmarrja

1. Nëse nuk ekzistojnë kushtet e mospranimit të kërkesës për rishikim, të parashikuara në nenin 16/6, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së me vendim të ndërmjetëm vendos kalimin e çështjes për shqyrtim në themel. Afati për shqyrtimin në themel është 60 ditë. Në përfundim të shqyrtimit në themel të çështjes, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos:

- a) lënien në fuqi të vendimit;
- b) shfuqizimin e vendimit;
- c) shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

2. Nëse gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim konstatohet se janë kushtet e nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit.

3. Procesi i shqyrtimit administrativ zhvillohet duke garantuar të drejtën për të dëgjuar të gjitha palët e interesuara.

4. Vendimet e dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim, duhet të plotësojnë të gjitha elementet e parashikuara në pikën 3 të nenit 15 të këtij ligji.

5. Kur vendimi nuk ankimohet brenda afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, ai përbën titull ekzekutiv.”.

Neni 4

Në nenin 28 afati “31 dhjetor 2008” zëvendësohet me afatin “31.12.2011”.

Neni 5

Nëse përpara çastit të hyrjes në fuqi të këtij ligji, kërkesi ka marrë dijëni për ekzistencën e shkaqeve për rishikimin e vendimit, sipas këtij ligji, afati i paraqitjes së kërkesës për rishikim është 45 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.57, datë 16.9.2010

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR SHKARKIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.6674, datë 14.9.2010 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.6674, datë 14.9.2010 për shkarkimin e zotit Ilir Meta, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme, nga detyra e Ministrit të Punëve të Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.58, datë 16.9.2010

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM
MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.6675, datë 14.9.2010 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.6675, datë 14.9.2010 për shkarkimin e zotit Dritan Prifti nga detyra e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.59, datë 16.9.2010

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM
MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.6676, datë 14.9.2010 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.6676, datë 14.9.2010 për emërimin e zotit Ilir Meta, Zëvendëskryeministër, në detyrën e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.60, datë 16.9.2010

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM
MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.6677, datë 14.9.2010 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.6677, datë 14.9.2010 për emërimin e zotit Edmond Haxhinasto në detyrën e Ministrit të Punëve të Jashtme.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.678, datë 13.8.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN
E INFERMIERISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR KUOTËN E
PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Infermierisë, të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Lëndët klinike”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në lëndët klinike”.

b) Doktoratë në “Lëndët paraklinike”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në lëndët paraklinike”.

2. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

3. Kohëzgjatja e këtyre programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën 3 (tri) vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2010-2011, është si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Lëndët klinike” 40 kuota;

b) Doktoratë në “Lëndët paraklinike” 40 kuota.

5. Në kuotën e mësipërme caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit për këto programe studimi të doktoratës, është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste, të caktuara nga Fakulteti i Infermierisë të Universitetit të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.679, datë 13.8.2010

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË 9-VJEÇARE “AKADEMIA BOTËRORE E TIRANËS”
(WORLD ACADEMY OF TIRANA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Akademia Botërore e Tiranës” (World Academy of Tirana), që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.680, datë 13.8.2010

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË E MESME “GJIMNAZI KRISTIAN I TIRANËS
“GJERASIM D.QIRJAZI””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat parauniversitar, shkollë e mesme “Gjimnazi Kristian i Tiranës “Gjerasim D.Qirjazi””, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.686, datë 2.6.2010

PËR KRIJIMIN E ORGANIT KOMBËTAR TË INVESTIGIMIT TË
AKSIDENTEVE/INCIDENTEVE AJRORE NË AVIACIONIN CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 93 të ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil, si një institucion juridik publik, në varësi të ministrit përgjegjës për transportet, me seli në Tiranë. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore ka vulën dhe stemën e vet zyrtare.

2. Objekti i veprimtarisë së Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore është investigimi i plotë i çdo aksidenti/incidenti ajror, në zbatim të ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, nëpërmjet kryerjes së shpejtë të procesit të investigimit dhe nxjerrjes së shkaqeve të aksidenteve/incidenteve ajrore.

3. Kriteret dhe procedurat, sipas të cilave Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore kryen funksionet dhe organizon procesin e investigimit, janë të përcaktuara në rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e investigimit të aksidenteve/incidenteve në aviacionin civil”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore, për veprimtarinë e tij, i raporton ministrit përgjegjës për transportin. Organi i paraqet ministrit, në çdo kohë, me kërkesë të tij, çdo të dhënë ose informacion në lidhje me veprimtarinë e tij.

5. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore, për të realizuar detyrat, përgjegjësitë dhe objektivat e përcaktuar në këtë vendim, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me institucionet e ndryshme të vendit, publike dhe/ose private, grupet e interesit, vendase dhe/ose të huaja.

6. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore, për të realizuar misionin dhe objektivat e tij, bashkëpunon me:

- Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO);
- Struktura të ngjashme të vendeve anëtare të Zonës së Përbashkët të Aviacionit Evropian (ZPAE), si dhe të vendeve të ndryshme të rajonit dhe të botës;
- Institucionet jofitimprurëse e donatorë të ndryshëm, vendas dhe/ose të huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

7. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore është institucion buxhetor dhe financohet nga Buxheti i Shtetit. Këshilli i Ministrave akordon fondet përkatëse, të mjaftueshme, për të realizuar procesin e plotë të investigimit, në rastin e ngjarjeve të caktuara.

8. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore drejtohet nga kryetari dhe ka në përbërje gjashtë inspektorë. Kryetari është titullari i institucionit dhe përfaqëson Organin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore, në marrëdhënie me të tretët. Struktura dhe organika e tij miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

9. Për emërimin e kryetarit dhe të inspektorëve të Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore duhet të plotësohen kërkesat dhe kriteret e mëposhtme:

- a) Të kenë shtetësi shqiptare;
- b) Të kenë arsim të lartë;
- c) Të jenë persona me përvojë profesionale, me aftësi teknike dhe menaxheriale, për çështje që kanë të bëjnë me sektorin e hapësirës ajrore dhe me sigurinë në fluturim;

- c) Të jenë me integritet moral dhe profesional;
- d) Të jenë të paangazhuar në funksione drejtuese partiake;
- dh) Të mos jenë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale;
- e) Të mos jenë të përjashtuar nga shërbimi civil;
- ë) Të mos kenë konflikt interesash me detyrën në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

10. Kryetari dhe inspektorët e Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në aviacion emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra me urdhër të ministrit përgjegjës për transportin, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

Mandati i kryetarit është 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

11. Organi Kombëtar për Investigimin e Aksidenteve/Incidenteve Ajrore ka, të paktën, një investigues të aftë për të kryer funksionin e investiguesit në detyrë, në rastin e një aksidenti apo incidenti të rëndë në aviacion, i cili duhet të jetë i kualifikuar dhe me përvojë pune në aviacion, sipas përcaktimeve në rregulloren bashkëlidhur.

12. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore rregullohen me Kodin e Punës. Niveli i pagave të punonjësve të tij përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.

13. Efektet financiare, sipas zërave “Fond page”, në vlerën 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, “Sigurime shoqërore”, në vlerën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, “Shpenzime operative”, në vlerën 2 000 000 (dy milionë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit. Numri i punonjësve prej 9 (nëntë) vetash përfshihet në numrin e përgjithshëm të punonjësve, të miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, për vitin 2010.

14. Vendimi nr.48, datë 28.1.1999 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bordit të hetimit të aksidenteve dhe incidenteve ajrore në aviacionin civil”, shfuqizohet.

15. Ngarkohet Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.688, datë 18.8.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në shkronjën “b” shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Përjashtohen nga ky rregull Ministria e Brendshme, njësitë shpenzuese në përbërje të programit buxhetor “Policia e Shtetit”, njësia shpenzuese e Gardës së Republikës dhe Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm.”.

2. Në fund të shkronjës “dh” bëhet kjo shtesë:

“Përjashtim bëjnë:

a) Njësiti e qeverisjes vendore;

b) Njësiti e fondeve speciale;

c) Ministria e Financave, e cila lejohet të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme:

i) Shtesë kontrate në vazhdim të kontratës fillestare me shoqërinë “Oracle”, me objekt “Transferim të njohurive dhe suport për sistemin AMoFITS”.

ii) Shtesë kontrate në vazhdim të kontratës fillestare me subjektin White&Case, me objekt “Konsulencë për emetimin e Eurobond-it”.

iii) Riparim dhe shërbim makinash 2010.

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila lejohet të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme, me objekt:

i) “Blerje pjesësh këmbimi për automjete”.

ii) “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit”.

d) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila lejohet të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme me objekt:

i) “Shërbim i automjeteve, për vitin 2010, për DPT-në”.

ii) “Hartim i projektzbatimit dhe preventivit përfundimtar për mjediset e shërbimit të tatimpaguesve dhe ngritje kati në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Korçë, shërbimi i tatimpaguesve, Drejtoria Rajonale, Shkodër dhe Elbasan, shtesë e mjedisëve në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Sarandë”.

dh) Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe disa institucione të varësisë, të cilat lejohen të vijojnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve, për studime e projekte të objekteve të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, për projektim objekti e shërbime, të përcaktuara në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

e) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e cila lejohet të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme, me objekt:

i) “Hartimi i projektzbatimit për rikonstruksionin e dhomave të serverave, për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, me fond limit 1 620 000 (një milion e gjashtëqind e njëzet mijë) lekë.

ii) “Shtrimi me fibër optik për zgjerimin e rrjetit kompjuterik ndërministror GovNet, në Tiranë, si dhe ndërtimi i tij në Durrës dhe Elbasan”, me fond limit 48 234 562 (dyzet e tetë milionë e dyqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.

iii) “Realizimi i kurseve profesionale për specialistët e fushës së teknologjisë dhe informacionit” për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe ministritë/institucionet e varësisë, me fond limit 9 735 120 (nëntë milionë e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzet) lekë.

iv) “Rritja e sigurisë dhe shërbimeve në rrjetin GovNet”, për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me fond limit 75 201 600 (shtatëdhjetë e pesë milionë e dyqind e një mijë e gjashtëqind) lekë.

v) “Realizimi i rikonstruksionit të dhomave të serverave, për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, me fond limit 46 000 000 (dyzet e gjashtë milionë) lekë.”.

3. Në shkronjën “ë” shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Për njësitë shpenzuese, në përbërje të programit buxhetor “Policia e Shtetit”, njësinë shpenzuese të Gardës së Republikës dhe Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, miratimi bëhet, përkatësisht, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Komandanti i Gardës së Republikës dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHKB-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA E PROKURIMEVE

Nr.	Objekti i prokurimit	Fondi limit në lekë	Emri i institucionit
1	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Berat	1 500 000	Bordi i kullimit Berat
2	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Durrës	1 500 000	Bordi i kullimit Durrës
3	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Elbasan	1 500 000	Bordi i kullimit Elbasan
4	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Fier	4 200 000	Bordi i kullimit Fier
5	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Korçë	8 000 000	Bordi i kullimit Korçë
6	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Kukës	3 000 000	Bordi i kullimit Kukës
7	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Lezhë	8 000 000	Bordi i kullimit Lezhë
8	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Lushnjë	3 000 000	Bordi i kullimit Lushnjë
9	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Mat	2 000 000	Bordi i kullimit Mat
10	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Kavajë	4 000 000	Bordi i kullimit Tiranë
11	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Vlorë	2 000 000	Bordi i kullimit Vlorë
12	Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Sarandë	2 000 000	Bordi i kullimit Vlorë
13	Studim, projektim, preventivin zyra për AZHBR	3 000 000	AZHBR Tiranë
14	Blerje reagenti dhe kimikate	4 800 000	ISUV Tiranë
15	Blerje kite diagnostikuese dhe antigene	6 800 000	ISUV Tiranë
16	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 361 654	Aparati i MBUMK
17	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	2 587 139	DRBUMK Berat
18	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	3 421 200	DRBUMK Durrës
19	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	980 392	DRBUMK Elbasan
20	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 575 600	DRBUMK Kukës
21	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	839 585	DRBUMK Shkodër
22	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	2 033 416	DRBUMK Tiranë
23	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	871 459	DRBUMK Vlorë
24	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 215 000	Bordi i kullimit Berat
25	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 815 540	Bordi i kullimit Durrës
26	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 271 000	Bordi i kullimit Elbasan
27	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	2 178 648	Bordi i kullimit Fier
28	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 452 000	Bordi i kullimit Gjirokastrë
29	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 632 000	Bordi i kullimit Korçë
30	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 900 000	Bordi i kullimit Lezhë
31	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	7 262 400	Bordi i kullimit Lushnjë
32	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	980 392	Bordi i kullimit Mat
33	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 869 600	Bordi i kullimit Shkodër
34	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	3 190 740	Bordi i kullimit Tiranë
35	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 047 600	Bordi i kullimit Vlorë
36	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	3 631 200	ISUV Tiranë
37	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 089 600	Enti i Farërave Tiranë
38	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	1 016 700	AKDC
39	Shërbimi i ruajtjes me rojë private	4 085 965	AKU

Shënim. Për shërbimin e ruajtjes me rojë private të vazhdojnë procedurat e prokurimit për periudhën e mbetur brenda fondeve limite fillestare, të përcaktuara si më sipër.

VENDIM
Nr.689, datë 13.8.2010

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTERIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT (PËRFITUESI), PËR SHUMËN 975 475 EURO, PËR SHËRBIMET E EKSPERTIZËS SË MARRËSIT, NË KUADËR TË STUDIMIT TË FIZIBILITETIT PËR PROGRAMIN “INFRASTRUKTURA VENDORE II”, FINANCIAR NGA FONDI I VEÇANTË (STUDIEN-UND BERATUNGSFONDS) 6021, DHËNË NGA QEVERIA GJERMANE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes financiare, ndërmjet KfW, Frankufurt am Main dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (përfituesi), për shumën 975 475 euro, për shërbimet e ekspertizës së marrësit, në kuadër të studimit të fizibilitetit për programin “Infrastruktura vendore II”, financiar nga fondi i veçantë (Studien-und Beratungsfonds) 6021, dhënë nga Qeveria Gjermane.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTERIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, MPPT (PËRFITUESI)
PËR 975 475.00 EURO

Për shërbime eksperti për përfituesin në kuadrin e një studimi fizibiliteti për programin “Infrastruktura bashkiake II”, financiar nga një fond i posaçëm (Studien-und Beratungsfonds) 6021 i dhënë nga Qeveria Gjermane.

Bazuar në autorizimin e dhënë nga Qeveria Gjermane, më datë 23.3.2010 dhe në kërkesën e Qeverisë Shqiptare, përfituesi dhe KfW-ja bëhen palë e kësaj marrëveshjeje financiare.

Neni 1

Shuma dhe objekti i kontributit financiar

1.1 KfW-ja i jep përfituesit një kontribut financiar prej deri në 975 475 00 eurosh.

Ky kontribut financiar nuk është i kthyeshëm, në përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 3.2.

1.2 Përfituesi e përdor kontributin financiar ekskluzivisht për financimin e shërbimeve të mëposhtme të ekspertëve:

Mbështetje për MPPT për përgatitjen e programit “Infrastruktura bashkiake II” duke bërë një studim të plotë fizibiliteti, për të katër bashkitë e përzgjedhura, në kuadër të programit (shërbimet e ekspertëve).

1.3 Përfituesi i jep partnerëve kontributet e plota dhe në kohën e duhur. Përfituesi i jep KfW-së, me kërkesë të kësaj të fundit, prova që dëshmojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Tatimet dhe taksat e tjera publike që i ngarkohen përfituesit ose konsulentit (duke përfshirë dhe tatimin mbi të ardhurat) dhe tarifatat e importit nuk mbulohen nga kontributi financiar.

Neni 2 Disbursimi

2.1 Përfituesi autorizon KfW-në të bëjë pagesa të përkohshme dhe përfundimtare nga kontributi financiar për konsulentin ose agjentin e tenderit. Këto pagesa bëhen në përputhje me progresin/ecurinë e shërbimeve të ekspertit mbi bazën e faturave origjinale që i paraqiten KfW-së (dhe një kopje përfituesit) dhe në përputhje me kontratat që nënshkruhen, përkatësisht, ndërmjet përfituesit dhe konsulentit, dhe ndërmjet përfituesit dhe agjentit të tenderit. Ky autorizim nga përfituesi konsiderohet të jetë një kërkesë për disbursim për të gjitha pagesat e përmendura më lart.

2.2 Për pagesa të kryera në një monedhë të ndryshme nga monedha e rënë dakord (monedha e huaj), KfW-ja i debiton përfituesit shuma të tilla në euro, siç veprohet nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë dhe shpenzimet e vogla që mund të dalin.

2.3 KfW-ja nuk është përgjegjëse për vonesat e shkaktuara në transferimin nga institucionet bankare të disbursimit ose dhënies së pagesave nga KfW-ja. Nëse vonesa shkaktohet nga KfW-ja, përgjegjësia e saj kufizohet në pagesën e interesit për vonesën.

2.4 KfW-ja ka të drejtën e refuzimit të disbursimeve pas datës 31.12.2011. Studimi planifikohet të ndërmerret brenda 4 muajve duke filluar nga nënshkrimi i kontratës së konsulencës.

2.5 Kontratat e konsulencës përmbajnë një dispozitë që parashikon se çdo rimbursim, garanci ose pagesë e ngjashme e pretenduar ose çdo pagesë siguracioni bëhet për llogari të përfituesit, në numrin e llogarisë 38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) nga KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), ku KfW-ja i derdh këto pagesa në llogarinë e përfituesit.

Neni 3 Pezullimi i disbursimeve dhe ripagimi

3.1 KfW-ja mund t'i ndërpresë disbursimet në rastet kur:

a) përfituesi nuk i realizon detyrimet e tij ndaj KfW-së për të bërë pagesat, kur vjen koha e pagesave;

b) cenohen detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje;

c) përfituesi nuk është në gjendje të provojë që shumatat e disbursuara janë përdorur të gjitha për qëllimin e parashikuar, ose

d) shfaqen rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose cenojnë seriozisht ekzekutimin e objektit të shërbimeve të ekspertit;

e) cenohet, përfundon ose anulohet kontrata e konsulencës që do të nënshkruhet ndërmjet përfituesit dhe konsulentit.

3.2 KfW-ja ka të drejtë të kërkojë ripagimin e menjëhershëm të kontributit financiar nëse shfaqet ndonjëra nga situatat e përmendura në nenin 3.1 b) dhe c) dhe nëse kjo situatë nuk eliminohet brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, gjithsesi, është të paktën 30 ditë. Në rastin e nenit 3.1 c), ripagimi kufizohet në shumatat të tilla për të cilat përfituesi nuk është në gjendje të provojë se ato janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

Neni 4 Kostot dhe tarifatat publike

Përfituesi mbulon të gjitha tatimet ose taksat e tjera publike jashtë Republikës Federale të Gjermanisë që lidhen me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që dalin në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

6.2 Menjëherë pas përfundimit të punës së shërbimit të ekspertit, KfW-ja pajiset me të gjitha kopjet e projekteve, raporteve, studimeve të bëra nga konsulenti që kërkohen prej KfW-së. KfW-ja mund të vlerësojë studime të caktuara.

6.3 Nga financimi i studimit, përfituesi mund të mos përfitojë të drejtën e financimit të projektit të përgatitur nga studimi. Gjithsesi, përfituesi i jep Republikës Federale të Gjermanisë opsionin e financimit të projektit nën bashkëpunimin financiar.

Neni 7

Shërbimet e konsulentit

7.1 Detyrat e konsulentit përfshijnë:

- Detyra 1: Inventarizimi i situatës ekzistuese;
- Detyra 2: Projektimi i popullsisë dhe projektimit;
- Detyra 3: Konceptimi i zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit;
- Detyra 4: Masat e projektit të identifikuara për programin e infrastrukturës bashkiake II;
- Detyra 5: Rishikimi mjedisor;
- Detyra 6: Kontrolli klimaterik;
- Detyra 7: Mbështetje për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve WSSC;
- Detyra 9: Vlerësimi i efikasitetit operativ të lidhjeve të ujësjellës-kanalizimeve WSSCs dhe vlerësimi i kërkesës dhe nivelit të përballimit të shërbimit nga popullsia.

7.2 KfW-ja ka të drejtën e pakufizuar të përdorimit dhe shfrytëzimit të rezultateve të shërbimeve të ekspertit dhe të të gjitha dokumenteve të tjera të financuara nga kontributi financiar në të gjitha kohërat dhe në të gjitha vendet në diskrecion të saj.¹

Neni 8

Dispozita të tjera

8.1 Përfituesi siguron se personat e ngarkuar prej tij me ekzekutimin e shërbimeve të ekspertit apo që marrin kontrata për shërbimet e ekspertit, të cilat financohen nga disbursime të shumave të kontributeve financiare nuk kërkojnë, pretendojnë, marrin, japin, premtojnë ose marrin premtime për pagesa të paligjshme ose avantazheve të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Me kërkesë të KfW-së, përfituesi i vë menjëherë në dispozicion KfW-së të gjithë informacionin dhe dokumentet e kërkuara prej saj për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me përfituesin, e cila është e nevojshme për këtë qëllim.

Me nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes financiare, përfituesi vepron në emrin e tij dhe për llogari të tij. Në lidhje me ligjin gjerman ose me ligjin e vendit të përfituesit:

a) Burimet e veta të përfituesit ose shumat e investuara në financimin e projektit nuk mund të kenë origjinë të paligjshme, dhe, në veçanti, ato nuk duhet të jenë të lidhura me trafikimin e drogave, korrupsionin, krimin e organizuar ose terrorizmin. Kjo listë nuk është shteruese;

b) Kapitali aksionar i përfituesit në asnjë kohë nuk duhet të ketë origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, ai nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë kohë me trafikimin e drogave, korrupsionin, krimin e organizuar ose terrorizmin (lista nuk është shteruese);

c) Përfituesi nuk angazhohet në blerjen, posedimin ose përdorimin e pronës me origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, ai nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë kohë me trafikimin e drogave, korrupsionin, krimin e organizuar ose terrorizmin (lista nuk është shteruese); dhe

d) Përfituesi nuk angazhohet në financimin e terrorizmit.

¹ Shtojca 1

Udhëzime për caktimin e konsulentëve për bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim.

8.3 Nëse njëra nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera të saj mbeten të paprekura. Çdo boshllëk i krijuar nga një dispozitë e tillë plotësohet nga një dispozitë, e cila është në përputhje me objektin e kësaj marrëveshjeje.

8.4 Përfituesi nuk mund të caktojë ose transferojë, të lërë peng ose të hipotekojë pjesë të kësaj marrëveshjeje.

8.5 Kjo marrëveshje drejtohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i kryerjes është Frankfurt am Main.

8.6 Marrëdhëniet ligjore të përcaktuara nga kjo marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe përfituesit përfundojnë 6 vjet pas disbursimit përfundimtar.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main
më 2010
KfW

Tiranë më 2010

Republika e Shqipërisë e përfaqësuar
nga Ministria e Punëve Publike dhe
Transportit (MPPT)

SHTOJCA 1
UDHËZIME PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME
VENDET NË ZHVILLIM

Linku i udhëzimeve

http://www.kfwentwcklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Consultingrichtlinie_E_11_200615701.pdf.

VENDIM
Nr.690, datë 13.8.2010

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET KfW,
FRANKFURT AM MAIN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT (PËRFITUESI), PËR SHUMËN
949 750 EURO, PËR SHËRBIMET E EKSPERTIZËS SË MARRËSIT, NË KUADËR TË
STUDIMIT TË FIZIBILITETIT PËR PROGRAMIN “INFRASTRUKTURA VENDORE I”,
FINANCIAR NGA FONDI I VEÇANTË (STUDIEN-UND BERATUNGSFONDS) 6021,
DHËNË NGA QEVERIA GJERMANE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes financiare, ndërmjet KfW-së, Frankfurt am Main dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (përfituesi), për shumën 949 750 euro për shërbimet e ekspertizës së marrësit, në kuadër të studimit të fizibilitetit të programit “Infrastruktura vendore I”, financuar nga fondi i veçantë (Studien-und Beratungsfonds) 6021, dhënë nga Qeveria Gjermane.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, MPPT (PËRFITUESI)
PËR 949 750 EURO

Për shërbime ekspertësh për përfituesin në kuadrin e programit “Infrastruktura bashkiake I”, financuar nga një fond i posaçëm (Studien-und Beratungsfonds) i dhënë nga Qeveria Gjermane.

Bazuar në autorizimin e dhënë nga Qeveria Gjermane në datën 23.3.2010 dhe në kërkesën e Qeverisë Shqiptare, përfituesi dhe KfW-ja bëhen palë e kësaj marrëveshjeje financiare.

Neni 1

Shuma dhe objekti i kontributit financiar

1.1 KfW-ja i jep përfituesit një kontribut financiar prej deri në 949 750.00 eurosh.

Ky kontribut financiar nuk është i kthyesëm, në përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 3.2.

1.2 Përfituesi e përdor kontributin financiar ekskluzivisht për financimin e shërbimeve të mëposhtme të ekspertëve:

Mbështetje për MPPT për përgatitjen e studimeve tarifore dhe masave teknike para fizibiliteti, duke përfshirë inspektimin e CCTV për të katër bashkitë e përzgjedhura në kuadër të programit “Infrastruktura bashkiake I” (shërbimet e ekspertëve).

1.3 Përfituesi i jep partnerëve kontributet e plota dhe në kohën e duhur. Përfituesi i jep KfW-së, me kërkesë të kësaj të fundit, prova që dëshmojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Tatimet dhe taksat e tjera publike që i ngarkohen përfituesit ose konsulentit (duke përfshirë dhe tatimin mbi të ardhurat) dhe tarifatat e importit nuk mbulohen nga kontributi financiar.

Neni 2

Disbursimi

2.1 Përfituesi autorizon KfW-në të bëjë pagesa të përkohshme dhe përfundimtare nga kontributi financiar për konsulentin ose agjentin e tenderit. Këto pagesa bëhen në përputhje me progresin e shërbimeve të ekspertit mbi bazën e faturave origjinale që i paraqiten KfW-së (dhe një kopje përfituesit) dhe në përputhje me kontratat që nënshkruhen përkatësisht ndërmjet përfituesit dhe konsulentit dhe ndërmjet përfituesit dhe agjentit të tenderit. Ky autorizim nga përfituesi konsiderohet të jetë një kërkesë për disbursim për të gjitha pagesat e përmendura më lart.

2.2 Për pagesa të kryera në një monedhë të ndryshme nga monedha e rënë dakord (monedha e huaj), KfW-ja i debiton përfituesit shuma të tilla në euro, siç veprohet nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë dhe shpenzimet e vogla që mund të dalin.

2.3 KfW-ja nuk është përgjegjëse për vonesat e shkaktuara në transferimin nga institucionet bankare të disbursimit ose dhënies së pagesave nga KfW-ja. Nëse vonesa shkaktohet nga KfW-ja, përgjegjësia e saj kufizohet në pagesën e interesit për vonesën.

2.4 KfW-ja ka të drejtën e refuzimit të disbursimeve pas datës 31.12.2011. Studimi planifikohet të ndërmerret brenda 6 muajve duke filluar nga nënshkrimi i kontratës së konsulencës.

2.5 Kontratat e konsulencës përmbajnë një dispozitë që parashikon se çdo rimbursim, garanci ose pagesë e ngjashme e pretenduar, ose çdo pagesë siguracioni bëhet për llogari të përfituesit, në numrin e llogarisë 38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) nga KfW-ja, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), ku KfW-ja i derdh këto pagesa në llogarinë e përfituesit.

Neni 6 Shërbimet e ekspertit

6.1 Përfituesi:

- a) i cakton shërbimet e ekspertit konsulentëve të pavarur e të kualifikuar (konsulenti) në përputhje me konceptimin e përfituesit dhe të KfW-së për shërbimet e ekspertit;
- b) pas përzgjedhjes fillestare dhe tenderit ndërkombëtar konkurrues, e njuh konsulentin si konsulent i pavarur i kualifikuar. Procedura e dhënies së kontratës bëhet sipas “Udhëzimeve për caktimin e konsulentëve për bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim” (shtojca 1), e cila është pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje;
- c) siguron financimin e plotë të shërbimeve të ekspertit dhe, me kërkesë të KfW-së, i jep KfW-së prova që dëshmojnë se kostot e papaguara nga ky kontribut financiar janë të mbuluara;
- d) mban ose shkakton mbajtjen e librave dhe të dhënave që tregojnë në mënyrë të qartë kostot e dala në lidhje me studimin dhe identifikojnë dukshëm shërbimet e financuara nga kontributi financiar;
- e) u bën të mundur përfaqësuesve të KfW-së që në çdo kohë të inspektojë këto libra dhe të dhëna, si dhe çdo dokumentacion tjetër të lidhur me ekzekutimin e shërbimeve të ekspertit;
- f) e pajis KfW-në me çdo informacion apo raport të tillë për shërbimet e ekspertit dhe progresin e tyre të mëtejshëm siç mund të kërkohej prej KfW-së;
- g) informon menjëherë KfW-në për të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose cenojnë seriozisht ekzekutimin e shërbimit të ekspertëve ose objektin e tyre;
- h) komenton raportet e konsulentit ose miraton përmbajtjen e tyre duke kundërfirmosur raportet; dhe
- i) merr vendimet e tij për të gjitha projektimet, raportet dhe zëvendësimin e anëtarëve të stafit të konsulentit në marrëveshje me KfW-në.

6.2 Menjëherë pas përfundimit të punës së shërbimit të ekspertit, KfW-ja pajiset me të gjitha kopjet e projekteve, raporteve, studimeve të bëra nga konsulenti që kërkohej prej KfW-së. KfW-ja mund të vlerësojë studime të caktuara.

6.3 Nga financimi i studimit, përfituesi mund të mos përfitojë të drejtën e financimit të projektit të përgatitur nga studimi. Gjithsesi, përfituesi i jep Republikës Federale të Gjermanisë opsionin e financimit të projektit nën bashkëpunimin financiar.

Neni 7 Shërbimet e konsulentit

7.1 Detyrat e konsulentit përmbajnë dy detyra kryesore, që realizohen nga dy skuadra të ndryshme konsulence:

- a) studimet e tarifave për katër ndërmarrjet e përzgjedhura në programin “Infrastruktura bashkiake I”, ku përfshihen përditësime të planeve të biznesit dhe planet përkatëse të veprimt. Konsulenti duhet të bashkëpunojë ngushtë me autoritetin rregullator ERRU;
- b) studimet teknike për shqyrtime të detajuara për sistemet e ujësjellës-kanalizimeve, duke përfshirë dhe inspektimin e CCTV-së.

7.2 KfW-ja ka të drejtën e pakufizuar të përdorimit dhe shfrytëzimit të rezultateve të shërbimeve të ekspertit dhe të të gjitha dokumenteve të tjera të financuara nga kontributi financiar në të gjitha kohërat dhe në të gjitha vendet në diskrecion të saj.²

² Shtojca 1

Udhëzime për caktimin e konsulentëve për bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim

Neni 8 Dispozita të tjera

8.1 Përfituesi siguron se personat e ngarkuar prej tij me ekzekutimin e shërbimeve të ekspertit apo që marrin kontrata për shërbimet e ekspertit, të cilat financohen nga disbursime të shumave të kontributeve financiare nuk kërkojnë, pretendojnë, marrin, japin, premtojnë ose marrin premtime të pagesave të paligjshme ose avantazheve të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Me kërkesë të KfW-së, përfituesi i vë në dispozicion KfW-së të gjithë informacionin dhe dokumentet e kërkuara prej saj për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me përfituesin, e cila është e nevojshme për këtë qëllim.

Me nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes financiare, përfituesi vepron në emrin e tij dhe për llogari të tij. Në lidhje me ligjin gjerman ose me ligjin e vendit të përfituesit:

a) Burimet e veta të përfituesit ose shumat e investuara në financimin e projektit nuk mund të kenë origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, ato nuk duhet të jenë të lidhura me trafikimin e drogave, korrupsionin, krimin e organizuar ose terrorizmin. Kjo listë nuk është shteruese;

b) Kapitali aksionar i përfituesit në asnjë kohë nuk duhet të ketë origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, ai nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë kohë me trafikimin e drogave, korrupsionin, krimin e organizuar ose terrorizmin (lista nuk është shteruese);

c) Përfituesi nuk angazhohet në blerjen, posedimin ose përdorimin e pronës me origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, ai nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë kohë me trafikimin e drogave, korrupsionin, krimin e organizuar ose terrorizmin (lista nuk është shteruese); dhe

d) Përfituesi nuk angazhohet në financimin e terrorizmit.

8.3 Nëse njëra nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera të saj mbeten të paprekura. Çdo boshllëk i krijuar nga një dispozitë e tillë plotësohet nga një dispozitë, e cila është në përputhje me objektin e kësaj marrëveshjeje.

8.4 Përfituesi nuk mund të caktojë ose transferojë, të lërë peng ose të hipotekojë pjesë të kësaj marrëveshjeje.

8.5 Kjo marrëveshje drejtohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i kryerjes është Frankfurt am Main.

8.6 Marrëdhëniet ligjore të përcaktuara nga kjo marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe përfituesit përfundojnë 6 vjet pas disbursimit përfundimtar.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main
më...2010
KfW

Tiranë
më...2010
Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar
nga Ministria e Punëve Publike dhe
Transportit (MPPT)

SHTOJCA 1 UDHËZIME PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM

Linku i udhëzimeve

http://www.kfwentwcklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Consultingrichtlinie_E_11_200615701.pdf.

VENDIM
Nr.691, datë 13.8.2010

**PËR NJË PËRJASHTIM NGA VENDIMI NR.53, DATË 21.1.2009 I KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA
MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përfundimisht nga përcaktimi i vendimit nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, për vitin kalendarik 2010, procedura e prokurimit për blerje letër offset për shtypjen e Fletores Zyrtare të kryhet nga vetë Qendra e Publikimeve Zyrtare, si autoriteti kontraktor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.692, datë 13.8.2010

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME, SI ORGAN QENDROR BLERËS, PËR
KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Brendshme, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, si dhe të autoriteteve kontraktore, përkatëse, për lidhjen e kontratave, për mallrat dhe shërbimet e mëposhtme:

- a) Blerje karburanti;
- b) Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike;
- c) Blerje materialesh kancelarie;
- ç) Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyre;
- d) Blerje materialesh pastrimi;
- dh) Blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;
- e) Blerje këpucësh;
- ë) Blerje tonerësh;
- f) Blerje pajisjesh elektronike dhe telekomunikacioni;
- g) Shërbim gatimi dhe shpërndarjeje ushqimi;
- gj) Shërbim i pastrimit;
- h) Shërbimi i rrjetit të komunikimit të gjendjes civile.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.693, datë 18.8.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1619, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE PËR EFEKT PAGE DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të neneve 24, 32 e 54 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronjat “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“ç) Për njësitë e qeverisjes vendore me 20 001-50 000 banorë:

- Kryetari 51 000-90 000 lekë;

- Nënkyetari 41 000-77 000 lekë.

d) Për njësitë e qeverisjes vendore me 5 001-20 000 banorë:

- Kryetari 41 000-77 000 lekë;

- Nënkyetari 28 000-68 000 lekë.

dh) Për njësitë e qeverisjes vendore me nën 5 000 banorë:

- Kryetari 37 000-54 000 lekë;

- Nënkyetari 27 000-42 000 lekë.”.

b) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të Bashkisë së Tiranës”, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe për nëpunësit e komunave”, që përmendet në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Lidhja nr.3 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të këshillit të qarkut”, që përmendet në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

e) Paragrafi i parë i pikës 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Paga e grupit (kolona 2) është sipas lidhjes nr.7 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

f) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët” në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike vendore, dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme “Diplomë të nivelit të dytë” (DND) apo “Diplomë të integruar të nivelit të dytë” (DIND) apo të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”,

përfitojnë një shtesë për kushte pune, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Miratimi i kësaj shtese do të bëhet, rast pas rasti, nga drejtoritë/njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje të plotë me përshkrimin e pozicionit të punës.”.

g) Lidhja nr.5 “Struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e policisë të bashkive e të komunave”, që përmendet në pikën 13, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

h) Në pikën 18, vlera “... 30 000 lekë në muaj” bëhet “...31 000 (tridhjetë e një mijë) lekë në muaj...”.

i) Në pikën 19, vlera “... nga 18 000 deri në 30 000 lekë në muaj” bëhet “... nga 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) deri në 31 000 (tridhjetë e një mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga të ardhurat e vetë njëjësive të qeverisjes vendore, për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKINË E TIRANËS

KLASA	PAGA MUJORE (LEKË)				SHTESA E POZICIONIT
	KATEGORITË	PAGA INDIVIDUALE			
		1	2	3	
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	1	2%		Nga 69 000 deri 115 000
II	II-a	1	2%		Nga 66 000 deri 105 000
	II-b	1	2%		Nga 58 000 deri 88 000
III	III-a	1	2%		Nga 32 000 deri 71 000
	III-a/1	1	2%		Nga 29 000 deri 62 000
	III-b	1 ose 2	2%		Nga 27 000 deri 54 000
IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%		Nga 25 000 deri 43 000
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%		Nga 23 000 deri 33 000

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË E TJERA, NJËSITË BASHKIAKE TË TIRANËS DHE NËPUNËSIT E KOMUNAVE

KLASA	KATEGORITË	PAGA MUJORE (LEKË)						
		PAGA INDIVIDUALE		SHTESA E POZICIONIT				
1	2	3	4	5	6	7	7	
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi në punë	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion
I	I-b	1	2%	Nga 25 000 deri 65 400	Nga 22 200 deri 59 000	Nga 20 600 deri 48 000	Nga 19 600 deri 33 500	Nga 17 000 deri 28 000
II	II-a	1	2%	Nga 24 000 deri 62 000	-	-	-	-
	II-b	1	2%	Nga 20 600 deri 52 800	Nga 19 600 deri 48 000	Nga 17 000 deri 38 500	Nga 16 500 deri 33 000	Nga 16 000 deri 25 300
III	III-a/1	1	2%	Nga 20 000 deri 47 000	Nga 18 600 deri 42 000	Nga 16 700 deri 36 500	Nga 15 500 deri 29 500	Nga 15 000 deri 24 500
	III-b	1 ose 2	2%	Nga 19 600 deri 42 800	Nga 17 000 deri 39 500	Nga 16 300 deri 34 500	Nga 15 000 deri 27 500	Nga 14 000 deri 24 000
IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	Nga 13 000 deri 30 600	Nga 13 000 deri 28 500	Nga 12 000 deri 27 500	Nga 12 000 deri 26 000	Nga 12 000 deri 20 600
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	Nga 12 000 deri 28 000	Nga 11 500 deri 25 000	Nga 11 500 deri 21 000	-	-

Shënim. Këshilli i bashkisë dhe i komunës, në përcaktimin e shtesës në pagë për pozicion, sipas ndarjes në njësi vendore, bazohet në numrin e banorëve të Regjistrit të Gjendjes Civile në fillim të vitit kalendarik

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË KËSHILLIN E QARKUT

KLASA	KATEGORITË	PAGA MUJORE (LEKË)			
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	1	2%		Nga 36 000 deri 71 000
II	II-a	-	-		-
	II-b	1	2%		Nga 23 500 deri 54 000
III	III-a/1	1	2%		Nga 23 500 deri 47 000
	III-b	1 ose 2	2%		Nga 19 000 deri 43 000
IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%		Nga 13 000 deri 33 000
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%		Nga 12 500 deri 24 600

STRUKTURA DHE KUFIJTË E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BASHKIVE E TË KOMUNAVE

Emërtesa	Paga (lekëmuaj)	
	Nga	deri
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	72 000	82 000
Kryeinspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50 000 banorë	57 000	65 000
Kryeinspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore nga 5001 deri në 50 000 banorë	44 000	49 000
Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	57 000	65 000
Inspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50 000 banorë	40 000	45 000
Inspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë	34 000	39 000
Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	44 000	49 000
Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, me mbi 50 000 banorë	34 000	39 000
Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë	32 000	37 000
Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, deri në 5001 banorë	29 000	32 000

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DIND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

VENDIM

Nr.694, datë 18.8.2010

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.748, DATË 11.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.748, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas kategorive të vendeve të punës, për nëpunësit e institucioneve publike të arsimit të lartë”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen nr.1 me të njëjtin titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në fund të pikës 7 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e personelit akademik, efektivë e joefektivë, që, për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi në institucione të arsimit të lartë që e kanë vendndodhjen në qytete të tjera, larg vendbanimit të tyre, për çdo orë mësimi të kryer në këto institucione, do të përfitojnë dyfishin e pagesave të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të kësaj pike, sipas kategorisë që ata kanë.”.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e institucioneve të arsimit të lartë, për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT
AKADEMIK, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

Nr. rendor	Pozicioni	Paga
1	Rektor (titullar institucioni)	125 000
2	Zëvendësrektor, nga kategoria “Profesorë”	120 000
3	Zëvendësrektor, nga kategoria “Docent”	118 000
4	Dekan nga kategoria “Profesorë”	120 000
	Dekan nga kategoria “Docent”	118 000
5	Zëvendësdekan nga kategoria “Profesorë”	107 000
6	Zëvendësdekan nga kategoria “Docent”	95 000
7	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Profesorë”	107 000
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Docent”	95 000
9	Profesor	103 500
10	Profesor i Asociuar	90 000
11	Docent	82 000
12	Lektor i parë/kërkues i parë	79 000
13	Lektor/kërkues	63 000

VENDIM

Nr.695, datë 18.8.2010

**PËR DHËNIE FONDI KËSHILLIT TË QARKUT TË LEZHËS, PËR RINDËRTIMIN E
KËMBËVE TË URËS SË GALLATËS DHE MONTIMIN E URËS TIP “BEILI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010” dhe të neneve 31 e 32, shkronja “a”, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli të qarkut të Lezhës, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i jepet fondi prej 5 976 489 (pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë, ndarë, si më poshtë vijon:

a) Për rindërtimin e këmbëve të urës së Gallatës, 5 476 489 (pesë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.

b) Për transportimin dhe montimin e urës tip “Beili”, 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe këshilli i qarkut të Lezhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM
Nr.696, datë 18.8.2010

**PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS ME
INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me institucionet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe, konkretisht, me Institutin e Shëndetit Publik dhe Inspektoratin Shtetëror Sanitar, për:

- a) hartimin e programeve të punës për organizimin e kontrolleve të përbashkëta;
- b) shkëmbimin e informacionit në rastet e konstatimit të shkeljeve të legjislacionit, që nuk mbulohen nga institucioni që kryen kontrollin;
- c) denoncimin e rasteve të aksidenteve në punë, si dhe të sëmundjeve profesionale nga sistemi i shërbimit shëndetësor, shtetëror dhe privat;
- ç) kryerjen e trajnimeve të përbashkëta për kualifikimin e specialistëve dhe të inspektorëve;
- d) kryerjen e studimeve për çështje të përbashkëta në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë;
- dh) hartimin dhe zbatimin e projekteve, që synojnë përmirësimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë të punëmarrësve.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.697, datë 18.8.2010

PËR CAKTIMIN E NIVELIT BAZË TË SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 2 të nenit 54 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Niveli bazë i së ardhurës nga papunësia të jetë 6 565 (gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në grupin 25, titull 10 550 kap.1, art 606 “E ardhura nga papunësia”.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi nr.631, datë 11.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.699, datë 13.8.2010

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR
UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, TË OBJEKTIT “DEPARTAMENTI I DETARISË”,
NË VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përdorim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Ismail Qemali”, të objektit “Departamenti i Detarisë”, pjesë e pronës nr.904, me emërtesë “Akademia e Detarisë”, në Vlorë, për zhvillimin e programit mësimor, deri më datën 30.9.2017.

2. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënien në përdorim të objektit, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.701, datë 25.8.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të nenit 10 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, dhe të nenit 38 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me propozimin e Kryeministrit, të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, lejohet Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme:

i) “Blerje orendish për zyra”, me fond limit 665 834 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë.

ii) “Blerje pajisjesh kompjuterike”, me fond limit 2 310 618 (dy milionë e treqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

iii) “Rikonstruksion i mjediseve të brendshme të zyrave të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, me fond limit 1 666 666 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.”.

Përfundimisht, lejohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucionet në varësi të saj, si autoritete kontraktore, të vijojnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme:

i) “Rehabilitimi i argjinaturës së Çasit, Shkodër”, me fond limit 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekë, për vitin 2010, fondi në dispozicion 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, dhe “Ndërtimi i argjinaturës në Darragjat”, me fond limit 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

ii) “Rehabilitimi i kanalit të Murtemzës (Ura e Gjo-Lulit -Kënetë e Vilunit”, me fond limit 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë.

iii) “Mirëmbajtje e hidrovorit, Ças, Vilun”, me fond limit 3 445 000 (tre milionë e katërqind e dyzet e pesë mijë) lekë.

iv) Objekteve për rehabilitimin e nënobjekteve të disa digave të rezervuarëve, në zonën e Elbasanit, të Lezhës, të Matit, të Tiranës e të Durrësit, sipas tabelës që i bashkëlidhet, me fond limit të përbashkët 59 000 000 (pesëdhjetë e nëntë milionë) lekë.

v) “Blerje karburanti”, me fond limit 8 800 000 (tetë milionë e tetëqind mijë) lekë, bordi i kullimit, Lezhë.

vi) “Blerje pjesësh këmbimi për makinerinë e rëndë”, me fond limit 2 491 000 (dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë) lekë, bordi i kullimit Shkodër.

vii) “Antigen për gjurmimin e brucelozës në gjedhe e alergen në të imta”, me fond limit 5 700 000 (pesë milionë e shtatëqind mijë) lekë.

viii) “Vaksinat për të imtat”, me fond limit 6 100 000 (gjashtë milionë e njëqind mijë) lekë.

ix) “Blerje pajisjesh dhe aparaturash laboratorike për Institutin e Sigurisë Ushqimore të Veterinarisë”, me fond limit 134 857 000 (njëqind e tridhjetë e katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

x) “Riparim i autoveturave të ministrisë”, me fond limit 4 000 000 (katër milionë) lekë.

xi) “Shërbim dhe pjesë këmbimi për sistemin e ngrohje - ftohjes së ministrisë”, me fond limit 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë.

Përfundimisht, lejohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet në varësi të saj, si autoritete kontraktore, të vijojnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme:

i) Punimet e projekteve të reja, rikonstruksionet e objekteve, si dhe pajisjet e arsimit bazë, të mesëm dhe profesional, referuar tabelës nr.3 “Projektet e arsimit” që i bashkëlidhet vendimit nr.2, datë 30.7.2010 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve “Për shpërndajen e fondeve të zhvillimit të rajoneve”.

ii) Dokumentacionin shkollor (regjistrat dhe amzat), për vitin shkollor 2010-2011, në të gjitha drejtoritë rajonale arsimore.

iii) Shërbimin e transportit të nxënësve e të mësuesve në 13 drejtori rajonale arsimore dhe zyra arsimore.

iv) Shërbimin e ruajtjes e të sigurisë me rojë civile të objektit “Ndërtesa e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës”.”.

2. Ngarkohen Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

	Emërtimi i objektit	Nga investimet	Bordi i kullimit
1	Diga të rezervuarëve, zona Fushë-Krujë, Durrës	6 000 000	Durrës
2	Diga e rezervuarit Posnovisht, Elbasan	6 000 000	Elbasan
4	Diga e rezervuarit Kashtë, Elbasan	2 000 000	Elbasan
5	Diga e rezervuarit Rajc, Elbasan	1 000 000	Elbasan
6	Diga e rezervuarit Zaranikë, Elbasan	5 000 000	Elbasan
12	Rikonstruksioni i hidrovorit, Shllinx	5 000 000	Lezhë
13	Diga e rezervuarit Trojza, Lezhë	6 000 000	Lezhë
15	Diga e rezervuarit Shtodër, Shkodër	5 000 000	Shkodër
16	Rehabilitimi i Argjinaturops së Çasit	50 000 000	Shkodër
17	Rehabilitimi i kanalit të Murtemzës (Ura e Gjo Lulit-Këneta e Vilunit)	30 000 000	Shkodër
18	Ndërtimi i argjinaturës në Darragjat	20 000 000	Shkodër
19	Rehabilitimi i argjinaturës Shirq-Belaj, Luarz-Pentar, Reç-Pulaj	5 000 000	Shkodër
20	Rikonstruksioni i paneleve elektrike të hidrovorit Veliopojë (Plazh Velipojë)	3 000 000	Shkodër
21	Diga e rezervuarit Hajdaraj, Kavajë	1 000 000	Tiranë
22	Diga e rezervuarit Zhabjak, Kavajë	2 000 000	Tiranë
23	Diga e rezervuarit Beden, Kavajë	2 000 000	Tiranë
24	Diga e rezervuarit Pekisht, Kavajë	1 000 000	Tiranë
25	Rehabilitimi i nënobjekteve të digave të rezervuarëve Mat e Dibër	9 000 000	Mat
	Totali	159 000 000	

		Nga shpenzimet art.602	
	Mirëmbajtje e hidrovorit Ças Vilun	3 445 000	Shkodër
	Blerje pjesë këmbimi për makinerinë e rëndë	2 491 000	Shkodër
	Blerje karburanti	8 800 000	Lezhë
	Totali	14 736 000	

VENDIM
Nr.702, datë 25.8.2010

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETIT TË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, TREGTAR DHE TEKNIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shtetit të Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE BILATERALE
MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, TREGTAR DHE TEKNIK NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETIT TË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE

Republika e Shqipërisë dhe Shteti i Emirateve të Bashkuara Arabe, këtu të quajtura “Palët kontraktuese”,

me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet e tyre miqësore dhe për të zhvilluar bashkëpunimin ndërmjet të dy vendeve në sferat ekonomike, tregtare dhe teknike mbi bazën e barazisë dhe përfitimit reciprok,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Palët përpiqen për të zhvilluar dhe fuqizuar bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik ndërmjet të dy vendeve, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre përkatëse në fuqi.

2. Bashkëpunimi mbulon fushat e mëposhtme:

- a) tregtinë,
- b) industrinë,
- c) bujqësinë,
- d) transportin,
- e) telekomunikacionin,
- f) arsimin, kërkimin shkencor,
- g) teknologjinë dhe inovacionin teknologjik,
- h) turizmin dhe
- i) investimet.

Neni 2

Për zbatimin e bashkëpunimit ekonomik, tregtar dhe teknik, në pajtim me termat e kësaj marrëveshjeje, palët inkurajojnë institucionet përkatëse të specializuara dhe personat fizikë të autorizuar për të parë mundësitë e zbatimit të projekteve në fushat e bashkëpunimit që përcaktohen në këtë marrëveshje, duke përfshirë mjetet e financimit të këtyre projekteve.

Neni 3

1. Palët inkurajojnë bashkëpunimin ekonomik nëpërmjet projekteve të përbashkëta në të dy vendet.
2. Palët marrin të gjitha masat e nevojshme për të nxitur bashkëpunimin tregtar dhe teknik ndërmjet institucioneve të specializuara dhe personave fizikë të autorizuar në të dy vendet, nëpërmjet shkëmbimit të ekspertëve, shkencëtarëve, teknikëve, studentëve dhe trajnerëve në fushat përkatëse.

Neni 4

1. Palët inkurajojnë pjesëmarrjen e personave fizikë dhe juridikë nga të dy vendet në panairët dhe ekspozitat ndërkombëtare që mbahen në territoret e tyre përkatëse.
2. Palët mbështesin shkëmbimin e vizitave të delegacioneve tregtare.

Neni 5

Të gjitha pagesat ndërmjet personave fizikë dhe juridikë nga të dy vendet, në lidhje me transaksionet e bëra në bazë të kësaj marrëveshjeje, kryhen në një monedhë lirisht të këmbyeshme.

Neni 6

Palët, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre në fuqi, ofrojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme për transportin, rieksporimin dhe ruajtjen e përkohshme të mallrave.

Neni 7

1. Një komitet i përbashkët i përbërë nga përfaqësues të të dy palëve themelohet për të bashkërenduar dhe nxitur bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik ndërmjet të dy vendeve, nëpërmjet:
 - a) ndjekjes së zbatimit të kësaj marrëveshjeje;
 - b) vlerësimit të propozimeve të bëra për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje;
 - c) zhvillimit të bashkëpunimit në fushat e përcaktuara në këtë marrëveshje ose në fusha të tjera të rëna dakord nga të dyja palët.
2. Komiteti i përbashkët i zhvillon mbledhjet e tij sipas nevojës me kërkesë të një prej palëve dhe aprovimin e palës tjetër.
3. Marrëveshjet, që përcaktojnë hollësitë dhe procedurat e bashkëpunimit specifik për sferat e përcaktuara në këtë marrëveshje nëpërmjet rekomandimeve të bëra nga komiteti i përbashkët, bëhen në pajtim me kërkesat e brendshme ligjore të palëve dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku ato janë palë.

Neni 8

Kjo marrëveshje nuk cenon të drejtat ose detyrimet e tjera që lindin marrëveshjet, traktatet dhe memorandumet në fuqi që janë lidhur nga Republika e Shqipërisë ose nga Emiratet e Bashkuara Arabe me një palë të tretë, duke përfshirë organizatat rajonale dhe/ose ndërkombëtare ekonomike.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve ose bisedimeve ndërmjet palëve.

Neni 10

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e fundit të këmbimit të njoftimeve pasi palët të kenë njoftuar njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave përkatëse të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 11

1. Kjo marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë pesëvjeçare duke filluar nga data kur kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi dhe zgjatet automatikisht për periudha të barabarta, përveç kur një palë i njofton palës tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, dëshirën e saj për ta përfunduar atë të paktën gjashtë muaj para mbarimit të afatit.

2. Në rastin e njoftimit të përfundimit të kësaj marrëveshjeje, detyrimet që rrjedhin nga kontratat e lidhura në bazë të dispozitave të saj dhe që nuk janë zbatuar, janë të vlefshme deri në zbatimin e plotë të kontratave.

Neni 12

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin reciprok të palëve; secila palë e njofton palën tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të brendshme, që kërkohen për hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve. Këto ndryshime hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të fundit.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në..... më..... në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rastin e mospërputhjes, mbizotëron teksti në anglisht.

VENDIM

Nr.704, datë 25.8.2010

PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS ME INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006, "Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me institucionet në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për:

a) shkëmbimin e informacionit për të dhënat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari me leje të posaçme të parashikuara në ligje të veçanta;

b) hartimin e programeve të punës për organizimin e kontrolleve të përbashkëta sipas problematikës;

c) shkëmbimin e informacionit në rastet e konstatimit të shkeljeve të legjislacionit që nuk mbulohen nga institucioni që kryen kontrollin;

ç) bashkëpunimin në rast të hetimit të aksidenteve në punë, si dhe të sëmundjeve profesionale;

d) kryerjen e trajnimeve të përbashkëta për kualifikimin e specialistëve e të inspektorëve;

dh) kryerjen e studimeve për çështje të përbashkëta në fushën e sigurisë e të shëndetit në punë;

e) hartimin dhe zbatimin e projekteve që synojnë përmirësimin e sigurisë e të shëndetit në punë të punëmarrësve.

2. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Inspektoratin Qendror Teknik për:

a) shkëmbimin e informacionit për të dhënat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari me leje nga IQT-ja, një herë në vit;

b) hartimin e programeve të punës për organizimin e kontrolleve të përbashkëta, gjatë të cilave inspektorët e IQT-së kontrollojnë zbatimin e legjislacionit në fuqi për sigurinë në punë të pajisjeve dhe instalimeve elektrike, të enëve nën presion dhe për naftën e gazin dhe nënproduktet e tyre, ndërsa inspektorët e ISHP-së kontrollojnë zbatimin e dispozitave që lidhen me kushtet e punës: kohëzgjatjen e punës e të pushimit, pagat, punësimin e të miturve, të grave shtatzëna dhe me fëmijë në gji;

c) kryerjen e hetimeve të përbashkëta, në rastet e aksidenteve në punë e të sëmundjeve profesionale dhe plotësimin nga të dyja palët të dokumentacionit të hetimit të aksidentit/sëmundjeve profesionale;

ç) kryerjen e trajnimeve të përbashkëta për kualifikimin e specialistëve dhe të inspektorëve;

d) kryerjen e studimeve për çështje të përbashkëta në fushën e sigurisë e të shëndetit në punë;

dh) organizimin, një herë në vit, të takimeve të përbashkëta, në nivel inspektorësh/drejtorësh të përgjithshëm.

3. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Repartin e Inspektim/Shpëtim-Minierave (RISHM) për:

a) shkëmbimin e informacionit për të dhënat e subjekteve, që ushtrojnë veprimtari me leje minerare nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, një herë në vit;

b) hartimin e programeve të punës për organizimin e kontrolleve të përbashkëta, gjatë të cilave inspektorët e IQT-së kontrollojnë zbatimin e legjislacionit në fuqi për sigurinë në punë të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike, të enëve nën presion dhe për naftën e gazin dhe nënproduktet e tyre, ndërsa inspektorët e ISHP-së kontrollojnë zbatimin e dispozitave që lidhen me kushtet e punës: kohëzgjatjen e punës e të pushimit, pagat, punësimin e të miturve, të grave shtatzëna dhe me fëmijë në gji;

c) në rastet e aksidenteve në punë në subjektet minerare me pasojë vdekjen ose jo të punëmarrësve, inspektorët e punës plotësojnë procesverbalin e aksidenteve në punë (formularin e ISSH-së), bazuar në relacionin e hetimit të aksidentit të përgatitur nga inspektorët e RISHM-it;

ç) kryerjen e trajnimeve të përbashkëta për kualifikimin e specialistëve e të inspektorëve;

d) kryerjen e studimeve për çështje të përbashkëta në fushën e sigurisë e të shëndetit në punë;

dh) organizimin, një herë në vit, të takimeve të përbashkëta në nivel inspektorësh/drejtorësh të përgjithshëm për çështjet e sigurisë e të shëndetit në punë në fushën minerare.

4. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.705, datë 25.8.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “MESHTEKEN” DHE MIRATIMIN E BONUSIT
NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Meshteken”, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Sheriff Builders”, sh.p.k., për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Meshteken”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 20.9.2010
Doli nga shtypi më 20.9.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë